VENDIM
Nr. 974, datë 28.10.2013

PËR NJË SHTESË FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT DHE AGJENCINË E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT (AKTI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2013, për mbulimin e shpenzimeve të transferimit të zyrave, të bëhet një shtesë fondesh për institucionet e mëposhtme:

a) Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit t'i shtohet fondi prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh;

b) Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) t'i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh.

2. Efektet financiare sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama